

VENDIM
Nr.417, datë 8.4.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA VERTOP, TË QARKUT TË BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin, territorial dhe administrativ, të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Vertop, të qarkut të Beratit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 6 (gjashtë) fletë, që përfundon me numrin rendor 224 (dyqind e njëzet e katër), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Vertop për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Njësia e qeverisjes vendore: komuna Vertop

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
171-186	Pyll+sip të tjera	Në pronesi
188	Siperf. Boshe	Në pronesi
194-301	Pyll+ të tjera	Në pronesi
306	Siperf. Boshe	Në pronesi
308-337	Pyll+ të tjera	Në pronesi
339	Pyll	Në pronesi
340	Sip e roduar	Në pronesi
344-346	Pyll	Në pronesi
350-358	Pyll+ të tjera	Në pronesi
360-376	Pyll+ të tjera	Në pronesi
378	Pyll	Në pronesi
380-382	Pyll+ të tjera	Në pronesi
430	Sip boshe	Në pronesi
434-436	Pyll+ të tjera	Në pronesi
439-455	Pyll+ të tjera	Në pronesi
470-478	Pyll+ të tjera	Në pronesi
480-481	Pyll+ të tjera	Në pronesi
550-562	Pyll+ të tjera	Në pronesi
594-633	Pyll+ të tjera	Në pronesi

657-676	Pyll+ të tjera	Në pronesi
693-698	Pyll+ të tjera	Në pronesi